



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KURBIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Laç, më _____._____.2023

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës – Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Shërbimeve dhe mirëmbajtje të mjeteve të vogla të Bashkisë Kurbin”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
34330000-9

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,916,200 (dy milion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e dyqind) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kurbin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9,*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Sigurimi i Ofertës: Në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 ”Për prokurimin publik”, Neni 83: Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Sigurimit të Ofertës. Vlera e kërkuar e sigurimit të ofertës është 2% e fondit limit pa TVSH: 58,324 (pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e njëzet e katër) lekë pa tvsh.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

c. Formulari i ofertës

Argumentimi: Në zbatim të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, cdo operator ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë pjesë të ofertës së tij edhe formularin e ofertës sipas Dokumenteve Standarte të Tenderit.

d. Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Njësia e Prokurimit e ka hartuar këtë kriter duke u bazuar në pikën 5, gërma”a”, neni 41 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, për të provuar se operatori ekonomik vepron konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti profesional i operatorëve ekonomik.

a) Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale.

Te jete i specifikuar ne QKB objekti i veprimtarisë së operatorit ekonomik i njëjtte ose ekuivalent me objektin e prokurimit.

Sipas percaktimeve të bera ne Shtojcën 8 të DST-ve (**Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/ Kualifikimit**).

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, nenin 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2021-2022), ku vlera e xhiros për të paktën njërin nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë **jo më e vogël se** 30% e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Duke qene lloji i procedures eshte “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, percaktimi i vleres se kerkuar eshte bere ne mbeshtetje te nenin 43, pika 2, germa “c” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku percaktohet se: *”Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë:..... b) 40% te vlerës se përlllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nen kufirin e ulët monetar.....”*;

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne nenin 43, pika 1 ” të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, ku percaktohet se: *”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”*.

Vendosja e ketij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar se ky kriter kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor per te vertetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron te gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare per te permbushur me sukses kontraten.

2.2.2. Operatori Ekonomik duhet te paraqese një dokument qe verteton se ka paguar te gjitha detyrimet e taksave dhe tarifave vendore, ne vendet ku operatori ka ushtruar apo ushtron aktivitet per vitin 2023 (sipas QKB) sipas percaktimeve ne ligjin 9632/2006 ” Per sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (**Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit**). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ne ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, ne ligjin nr.9920 date 19.05.2008 “Per procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 3.1/a, b, c dhe neni 40, ne ligjin nr.131/2015 “Per QKB” i ndryshuar, si dhe ne ligjin nr.9723 date 03.05.2007 “Per QKR” i ndryshuar.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, si dhe kopje të kontratës.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që kontratat (shërbimet) e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në një vlerë jo më të vogël se 20 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate, për shërbime të ngjashme të kryera tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 20 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencë të vlefshme lëshuar nga QKB, Kodi: VII.3.B.1 “*Autoriparim i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiator*”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4, gërma “a”, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës Nr.1546, datë 29.03.2016, “*Autoriparimi i mjeteve rrugore me motor dhe rimorkiove*”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin si më poshtë:

A. Operatori ekonomik duhet të ketë te punësuar në stafin e tij, të paktën:

1 (një) Inxhinier mekanik/teknik/mekanik transporti, në detyrën/rolin e **drejtuesit teknik**.

Për punonjësën e drejtuesit teknik, OE duhet të paraqesi diplomë perkatëse si dhe kontratën e punës ku te jete percaktuar roli i tij si drejtues teknik si dhe te figurojë në listëpagesa.

B. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë personelin e nevojshëm për realizimin e kontratës, në përbërje të cilit të ketë minimalisht 4 (katër) punonjës, pjesë të stafit ose të kontraktuar, sipas profileve të mëposhtme:

- 1 (një) Xhenerik/Mekanik
- 3 (tre) punonjes ndihmes

Per punonjesit e mesiperm duhet te paraqiten kontratat individuale te punes.

Kjo kërkesë, do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit). Ndërsa dokumentacioni provues, do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë një drejtues teknik për kryerjen e shërbimeve i cili kanë një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e punimeve pasi ata janë përgjegjës për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e veçanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit, sikundër janë, kontratë pune e vlefshme, diploma etj janë vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet.

Gjithashtu referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic jane riparime dhe mirmbajtje të agregatit të motorrit, te sistemeve drejtimit, etj eshte e nevojshme pasja e nje stafi teknik me profesione si xhenerikë/mekanik, punonjes ndihmes e vertetuar kjo ne baze te kontratave te punës si dhe të deklaratës se plotësuar nga operatori ekonomik me qellim realizimin me sukses të kontrates. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit pjese te stafit ose te kontraktuar.

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht **6 (gjashtë) përsona**, vërtetuar me:

- a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj; per periudhen muajin e fundit të deklaruar.
- b. Listpagesat e punonjesve te konfirmuara nga autoritetet perkatese sipas formatit qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi, per periudhen muajin e fundit të deklaruar.

Kjo kërkesë, *do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e Formularit shtojcës Nr.9 (Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit).* Ndërsa dokumentacioni provues, *do të dorëzohet vetëm nga operatori ekonomik i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, sipas parashikimeve të nenit 26, të VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.*

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore te te nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i përcaktuar i punonjësve është përlllogaritur si më poshtë:

Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështrirje për periudhen muajin e fundit, tregon besueshmëri për autoritetin që operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është një prove bindese per AK që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës duke marre ne konsiderate se rendesine e ktij sherbimi per AK.

Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit, e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështrirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës.

2.4 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

2.4.1 Subjekti ofertues duhet të paraqesë edhe deklaratat si me poshte:

- a) Fletë garancinë e mallrave ose deklaratë, ku të deklarohet marrja përsipër e garancisë së mallit prej jo me pak se 6 (gjashte) muaj nga momenti i venies ne pune.
- b) Ofertuesi duhet te deklaroje se merr përsipër transportin e automjeteve të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, nga vend bllokimi i tyre deri në servis, me karrotrec/rimorkiator me shpenzimet e tij.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që

operatorët ekonomikë të dëshmojnë disponibilitet e nevojshme për realizimin me sukses të kontratës sipas kërkesave të AK.

2.4.2 Ofertuesi duhet të disponojë në pronësi / me qira ose kontratë bashkëpunimi një pike servisi jo më larg se 20 km nga Bashkia Kurbin ku përfshihen: ambiente oficine, ambiente për magazinimin e pjesëve të këmbimit (e verifikueshme nga KVO në ekstraktin e QKB-se në mënyrë elektronike)

Kriteri i distancës kërkohej për shkak të specifikës së objektit të prokurimit, pasi kontraktimi me një pike servisi me të largët do të shkaktojte kosto ekstra në buxhetin e Bashkisë Kurbin (karburant, kohe pune të burimeve tjera).

Për të provuar disponimin e pikës së servisit OE duhet të paraqesë:

- Në rast të disponimit të pikës së servisit në pronësi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vërtetojnë pronësinë e tij
- Në rast të pikenë e servisit të marrë me qira/kontratë bashkëpunimi krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirës/ bashkëpunimit.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në nenin 77 të pikës 4 dhe 5, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 41, pika 6, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohej që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në një pike servisi jo më larg se 20 km nga Bashkia Kurbin.

Ky kriter është vendosur për të provuar disponueshmërinë e pikës së servisit jo më larg se 20 km, nga Bashkia Kurbin, dhe për të garantuar ekzekutimin me sukses të kontratës, nëse operatori shpallë fitues. Përcaktimi i distancës prej jo më shumë se 20 km nga vendodhja e mjeteve është vendosur për të bërë të mundur mos shkaktimin e kostove ekstra në buxhetin e Bashkisë Kurbin (karburant, kohe pune të burimeve tjera).

2.4.3 Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikatën e vlefshme:

- ISO 9001:2015 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) ose ekuivalent e vlefshme të akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, dhe nenin 44 pika 1 dhe 3 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Për vet natyrën e kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatori ekonomik të jetë i certifikuar për cilësinë e kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit

kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Shënim: Ne zbatim të pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, ku parashikohet: *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin...”*, **sjellim ne vemendje se:**

- Disponimi i dokumentave të kërkuara më sipër do të dëshmohet nëpërmjet paraqitjes së Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit gjatë fazes së ofertimit.
- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit duhet t’i dergojë kerkese në rrugë elektronike (nëpërmjet sistemit të APP) ofertuesit të kualifikuar i pari, që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.
- Mosparaqitja e dokumentacionit do të jetë kusht s’kualifikimi si dhe do të veprohet sipas nenit 83 pika 3 dhe 5 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.
- Autoriteti Kontraktor do të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimet e bera gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar perben kusht s’kualifikimi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me nenin 36, të LPP, si dhe të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, referuar shkresës Nr.4881 Prot, datë 24.10.2023.

SPECIFIKIME TEKNIKE

I. LLOJET E AUTOMJETEVE:

- A. Automjeti me targë AA156KH me Nr. Identifikimi WF0GXXPSG4Y26779.
- B. Automjeti me targë AA157KH me Nr. Identifikimi WDG2021931F875551.
- C. Automjeti me targë AA651PJ me Nr. Identifikimi WVWZZZ3CZ7P057390.
- D. Automjeti me targë AA652PJ me Nr. Identifikimi WVWZZZ3CZ6E005285.
- E. Automjeti me targë AA654PJ me Nr. Identifikimi WVWZZZ3BZ5P021321.
- F. Automjeti me targë AA535PX me Nr. Identifikimi WDC1641201a102195.
- G. Automjeti me targë AA426PJ me Nr. Identifikimi WMAL20H213G113655.
- H. Automjeti me targë LA7283A me Nr. Identifikimi WDB6023161P167194.
- I. Automjeti me targë AA232MO me Nr. Identifikimi WDC1631131X724619.
- J. Automjeti FADROME JBC (3-CX-4) me targë ABMT03.

II. TERMAT E REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Detyrat:

- “**Autoriparim**” është *riparimi dhe mirëmbajtja* e mjeteve me motor dhe e rimorkiove, të destinuara për transportin rrugor të udhëtarëve dhe të mallrave, *me përjashtim të* shërbimeve të larjes, të fryrjes së gomave, të furnizimit me karburant, zëvendësimit të filtrit të ajrit dhe të vajit, të lëndës djegëse dhe të lubrifikantëve, të lëngjeve punuese hidraulike dhe të lëngjeve ftohëse.
- “**Veprimtari të riparimit**” janë të gjitha operacionet për zëvendësimin dhe modifikimin e çdo komponenti të mjeteve me motor dhe rimorkiove, si dhe instalimin e impianteve e të komponenteve fikse në një mjet të vetëm ose në një kompleks mjetesh me motor.
- “**Veprimtari e mirëmbajtjes së mjeteve me motor dhe të rimorkiove**” është mirëmbajtja e pjesëve mekanike dhe të motorit, të karrocërisë, të impiantit elektrik dhe të gomave.
- “**Agreat**”: përbëhet nga shumë pjesë këmbimi të ndryshme të lidhura në çiftëzime, të lëvizëshme dhe të palëvizëshme për të kryer një proces pune të caktuar e cila ka një vlerë monetare relativisht të lartë (p.sh. agregati i motorit, kutia e shpejtësisë, ridoto, diferencial).
- “**Paijsja**”: përbëhet nga disa pjesë këmbimi të çiftëzuara, që kryen një punë të caktuar dhe ka një vlerë relativisht mesatare (p.sh. pompa të ndryshme, motorino, alternator, amortizator transmesion etj).
- “**Pjesë këmbimi**”: përbëhet nga një ose më shumë detale dhe kryen një funksion të caktuar dhe ka një vlerë relativisht të ulët (p.sh. koka paraleli, koka avantreni, krah të ndryshëm, ferrota freni, ingranazhe, kushineta, premistop, gomina etj).

III. SPECIFIKIMET TEKNIKE

- **Të përgjithshme:**

- Pjesët e këmbimit duhet të jenë të reja , të pa përdoruara dhe prodhim sipas standardit CE.
- Pjesët e këmbimit duhet të kenë garanci jo me pak se 6 (gjashtë) muaj nga momenti i vënies në punë të tyre.
- Shoqëria kontraktuese, mban përgjegjësi për çdo defekt ose mospërputhje të pjesëve edhe kur defekti/mospërputhja shfaqet gjatë procesit të montimit/riparimit.
- Shoqëria kontraktuese, pas marrjes së njoftimit për **mospërputhje ose defekt** duhet të zëvendësojë mallin ose pjesën menjëherë dhe gratis.
- Të gjitha pjesët të kenë të etiketuar, numrin e referencës (kodin e pjesës) (Serisë) dhe vendin e prodhimit të tyre.
- Pjesët e këmbimit duhet të jenë të ambalazuara.
- Pika e servisit te jete jo me larg se 20 km nga Bashkia Kurbin ku perfshihen: ambiente oficine, ambiente per magazinimin e pjeseve te këmbimit.
- Afati i shërbimit te jete me shtrirje kohore deri ne fund te vitit por shërbimi pranohet nëse kryhet edhe më para këtij afati.
- Likuidimi do te behet ne situacione pjesore.
- Ofertuesi duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se 6 (gjashtë) punonjës për të kryer shërbimin. Ofertuesi duhet të ketë ne stafin e tij ose të kontraktuar për të gjithë periudhën e zbatimit të kontrates 1 (nje) Inxhinier Mekanik (Drejtues Teknik) dhe personelin e nevojshem per realizimin e kontrates si: Xhenerik/Mekanik si dhe punonjes shërbimi.
- Ofertuesi duhet te kete ne dispozicion minimalisht 1 (nje) karrotrec.

- **Klasifikimi i Riparimeve:**

- Riparime profilaktike (pjesët e ndërrimit që zëvendësohen me kohë përdorimi),
- Riparime difektesh (zëvendësim pjesë ndërrimi të konsumuara),
- Riparime të përgjithshme (kthimi i agregatit në parametrat fillestar).

- **Të dhëna teknike për Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit:**

- Duhet të jenë të reja, të pa përdoruara dhe prodhim sipas standardit CE.
- Vaji i motorrit të jetë i çertifikuar sipas standarteve ndërkombëtare ACEA 50400-50700, API ose standardeve kombëtare / ndërkombëtare ekuivalente me to.
- Vaji i kutisë së shpejtësisë, ridotos, diferencialit dhe vaji hidraulik të jenë çertifikuar sipas standarteve ACEA, API ose standardeve kombëtare / ndërkombëtare ekuivalente me to.
- **Gomat**

Gomat të jenë të reja (të pa riveshura).

Në sipërfaqet anësore, çdo gomë duhet të ketë të stampuara këto të dhëna:

- Prodhesi (marka)
- Emërtimi i gomës
- Përmasat e gomës (sipas kërkesave) dhe profili i batistradës

- Indeksi i ngarkesës dhe i shpejtësisë
- Struktura e gomës (radiale ose diagonale)
- Tipi i gomës (*Tubeless / Tube Type*).
- Numri i miratuar **UN/ECE** i prodhuesit të gomës (tregon se prodhimi i gomave bëhet në përputhje me rregullat e vendosura nga UN/ECE)
- **E** (standarti i BE) ose **DOT** (standarti amerikan).
- Kodi i prodhuesit të gomës.
- Kodi i gomës (për shembull **EA** – Kodi i gomës **295/80 R 22.5**).
- Data e prodhimit (për shembull **1019** - prodhuar në javën e dhjetë të vitit 2019).

Të jenë të prodhimit për përdorim për 4 stinë, me simbolet dhe shenjat përkatëse. Të kenë të stampuar datën e prodhimit të javës dhe vitit.

Të jenë të prodhimit jo më herët se 12 muaj nga data e zhvillimit të tenderit.

Gomat e një dimensionit të jenë të gjitha të të njëjtit tip prodhimi.

Garancia jo më pak se 40.000 (dyzetë mijë) kilometra. Shoqëritë gjatë periudhës së garancisë janë të detyruara të kryejnë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga enti pritës i mallit.

- **Bateri**

Karakteristikat baze të Baterive

- Tensioni nominal U_n : 12 V
- Me kapacitet 80Ah-CCA : Vlera e rrymes elektrike në $-18^\circ\text{C} \geq 750 \text{ A(EN) - E380}$
- Me kapacitet 100Ah-CCA : Vlera e rrymes elektrike në $-18^\circ\text{C} \geq 900 \text{ A(EN) - E5100}$
- Me kapacitet 92 AH : Vlera e rrymes elektrike në $-18^\circ\text{C} \geq 850 \text{ A (EN) - START\&STOP}$
- Operacioni Temperatura Gama nga -40°C deri në $+60^\circ\text{C}$ E mbushur, Xhel-Acid

Koha e prodhimit të baterive të jetë jo më shumë se 6 muaj nga dita e lëvrimit të mallit nga shitësi;

Bateritë duhet të jenë të plotësuara me solucion në rastin kur ato janë hermetike

Në raste specifike, kur nevojiten bateri me pozicion të poleve (+ ose -) në vend ndodhje të kundërta në bateri, shitësi të marrë përsipër zëvendësimin reciprok të tyre.

Bateritë të garantojnë punë të rregullt deri në 24 muaj nga dita e furnizimit.

Baterite të kënaqësive të stampuara në trupin e tyre marketimin me shkrim të qartë të dhenat:

- Numrin serial të baterise

- Tipin
- Prodhuesin
- Tensionin e Punes
- Kapacitetin
- Rrymen ne (-18°C) ose vleren CCA-ne Amper
- Daten e Prodhimit
- Koha e perdorimit sipas muajeve deri ne pese vite
- Ne trup te jete dhe syri tregues i gjendjes se baterise (sipas ngjyrave Jeshile, zeze) test.
- Koha e garancise te jete jo me e vogel se 24 muaj, nga koha e levrimit te mallit
- Gjate periudhes se garancise, furnizuesi ka per detyre te zvendesoje me shpenzimet e veta, baterine e demtuar jo per shkak te shfrytezuesit.

- **Afatet e kryerjes së shërbimit:**

- Riparim profilaktik (ndërrim filtra dhe vaji i motorrit), jo me shumë se katër orë,
- Riparim profilaktik (rrip faze/zinxhir motori) kit, jo më shumë se tetë orë,
- Riparime xhenerike (brenda një sistemi), jo më shumë se tetë orë,
- Riparime xhenerike (me shume se një sistem) jo më shumë se gjashtëmbdhjetë orë,
- Diagnostikim dhe riparime elektrike jo më shumë se katër orë,
- Riparime kapital, agregat motori, jo më shumë se 120 orë,
- Riparime në motor (guarnicion testate, ndrrim fasho motorri) jo më shumë 24 orë,
- Riparim kuti shpejtësie jo më shumë se 16 orë,
- Riparim diferenciali jo më shumë se 16 orë,
- Riparime të dëmtimitv të karocerisë (i lehtë), jo më shumë se 24 orë,
- Riparime të dëmtimit të karrocerisë (i mesëm), jo më shumë se 48 orë,
- Riparime të dëmtimit të karrocerisë (i rëndë), jo më shumë se 120 orë,

- **Shërbimi që kërkohet:**

- Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve nga ana e Operatorit Ekonomik, do të kryhet sipas kërkesave teknike dhe në përputhje të plotë me normat dhe standartet e miratuara për këtë qëllim.
- Riparimet / mirëmbajtja e mjeteve pranë Operatorit Ekonomik, do të kryhet në mënyrë periodike, sipas kërkesave të Autoritetit Kontraktor.
- Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes pa pagesë të shërbimeve të riparimit / mirëmbajtjes që rezultojnë jo sipas kushteve teknike dhe afateve të garancisë, të përcaktuara në termat e referencës dhe specifikimet teknike, sipas afateve të kryerjes së shërbimit.
- Operatori Ekonomik ka detyrimin e kryerjes së transportit të mjeteve, të cilat janë të difektuara dhe nuk kanë mundësi për vetëlëvizje, nga vend bllokimi i tyre deri në servis, nëpërmjet shërbimit me karrotrec dhe pa pagesë shtesë.

• **Detyrat në lidhje me shërbimin:**

- Mjeti paraqitet në servis, nga përfaqesuesi/it e Autoritetit Kontraktor, ku mbasi i është kryer procesi i larjes, i nënshtrohet kontrollit teknik nga ana e specialistëve të Operatorit Ekonomik.
- Në prezencë të përfaqesuesi/ve të Autoritetit Kontraktor, Operatori Ekonomik mbasi ka kryer testimin e difektimit të mjetit, në paisjet përkatëse, evidenton difektet e mundëshme dhe përpilon preventivin teknik/situacionin.
- Gjatë procesit të riparimit përfaqesuesi/it e Autoritetit Kontraktor dhe Operatori Ekonomik kryen verifikimet e nevojshme në riparimet e kryera, pjesët e ndërrimit të zëvendësuara dhe kohën e harxhuar.
- Me përfundimin e riparimit të mjetit, personi/at përgjegjës, të autorizuar pranë servisit, njofton Autoritetin Kontraktor, për përfundimin e riparimit të mjetit, në mënyrë që të bëhet tërheqja e mjetit pranë servisit.
- Përfaqesuesi/it e Autoritetit Kontraktor paraqitet pranë servisit dhe bën verifikimin e shërbimit të kryer dhe pjesët e ndërrimit të zëvendësuara, sipas preventivit të miratuar. Nëse të dy palët janë dakortësuar, mbi volumin e punimeve të kryera, hartohet procesverbal i përbashket, në tre kopje, në prani të përfaqesuesit/ve të Autoritetit Kontraktor dhe Operatorit Ekonomik.
- Pas kontrollit të mjetit, në paisjet kontrolluese, dhe firmosjes së procesverbalit përfaqesuesi/it e Autoritetit Kontraktor tërheq automjetin nga servisi.
- Proçesi përfundimtar i riparimit të mjetit, krahas procesverbalit, shoqërohet me faturën tatimore dhe aktin e garancisë së riparimit.

Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e kësaj procedure, Njësia e Prokurimit autorizon personin përgjegjës për prokurimin.

Në përfundim u vendos vazhdimi i mëtejshëm i procedurave ligjore të prokurimit.

NJËSIA E PROKURIMIT:

1. Pjeter Bushi Kryetar (Përsoni përgjegjës)
2. Sami Kulla Anëtar
3. Rudolf Toma Anëtar